



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 69

Tiranë – E martë, 5 maj 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 33/2015 datë 2.4.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruar nga BERZH-i, nga burimet e veta, nën fondin e veçantë të aksionarëve, për Strategjinë e Taksimit Rrugor në Shqipëri.....	3105
Ligj nr. 42/2015 datë 16.4.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore.....	3113



LIGJ
Nr. 33/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, SI ADMINISTRATOR I FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA BERZH-i, NGA BURIMET E VETA, NËN FONDIN E VEÇANTË TË AKSIONARËVE, PËR STRATEGJINË E TAKSIMIT RRUGOR NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruar nga BERZH-i, nga burimet e veta, nën fondin e veçantë të aksionarëve, për Strategjinë e Taksimit Rrugor në Shqipëri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.4.2015

Shpallur me dekretin nr. 9066, datë 28.4.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJA E GRANTIT

NR. C26374/EBSF-2011-10-161

MARRËVESHJA E GRANTIT PËR STRATEGJINË E TAKSIMIT RRUGOR NË SHQIPËRI

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË I PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SI ADMINISTRATOR I FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA BERZH-i NGA BURIMET E VETA, NËN FONDIN E VEÇANTË TË AKSIONARËVE
[data]

Marrëveshja e Grantit nr. C26374/EBSF-2011-10-161, në datën midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Marrësi) dhe Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka ose BERZH) me zyrat qendrore në One Exchange Square, London EC2A 2JN, United Kingdom, një institucion financiar i krijuar në përputhje me Marrëveshjen për Themelimin e Bankës, firmosur në Paris, më 29 maj 1990, e cila vepron si administratori i fondeve grant, të cilat mbahen në Fondin e Veçantë të Aksionarëve, të siguruar nga BERZH-i nga burimet e veta (Donatori).

HYRJE

Duke pasur parasysh se Bankës i është kërkuar të ofrojë bashkëpunim teknik për Marrësin në formën e shërbimeve të konsulencës financiare për përgatitjen e një strategjie për vendosjen e taksimit rrugor për Shqipërinë (Projekti, Strategjia për Taksimin Rrugor në Shqipëri), në të cilën janë përcaktuar objektivat e taksimit dhe janë identifikuar seksionet e mundshme të përshtatshme për taksim (Shërbimet),

duke pasur parasysh se Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) do të sigurojë një konsulent (Konsulenti), në përputhje me Politikat dhe Rregullat për Prokurim dhe me procedurat e tjera të BERZH-it,

duke pasur parasysh se MTI-ja do të lidhë një Kontratë Konsulente për parashikimin e Shërbimeve të Konsulentit (Kontrata e Konsulencës) për shumën tavan deri në 149,117.00 euro,



duke pasur parasysh se sipas Marrëveshjes së Fondit për Bashkëpunim Teknik, midis Donatorit dhe Bankës, Donatori ka rënë dakord dhe ka miratuar vënien në dispozicion të fondeve deri në vlerën 149,117.00 euro; në formën grant (Granti) për të financuar Shërbimet e Konsulentit sipas kushteve të mëposhtme,

duke pasur parasysh se Marrësi do të ndërmarrë çdo masë të nevojshme në përputhje me ligjin shqiptar për ta bërë Grantin të disponueshëm për MTT-në, me anë të një marrëveshjeje për transfertë, për qëllimin e specifikuar në kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje,

duke pasur parasysh se Marrësi duhet të përcaktojë si kusht për marrjen e Grantit se, për të përfituar Shërbimet, MTT-ja duhet të pajtohet me të gjitha detyrimet kontraktuale të përcaktuara në këtë Marrëveshje për Grant për MTT-në,

duke pasur parasysh se Banka ka rënë dakord të administrojë Grantin sipas kushteve të përcaktuara më poshtë,

për këtë arsye, palët bien dakord me kushtet në vijim:

Neni 1

Përkufizimet

1.01 Përkufizimet dhe interpretimi

Termet e mëposhtëm me shkronjë të madhe do të kenë kuptimet e përcaktuara më poshtë, në cilëndo pjesë të kësaj Kontrate, me përjashtim të rastit kur konteksti kërkon një tjetër kuptim:

a) “Kostot e Detyrës” do të thotë Kostoja e Shërbimeve;

b) “Banka ose BERZH-i” do të thotë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;

c) “Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ose MTT” do të thotë Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, palë së cilës do t’i ofrohen Shërbimet sipas Kontratës së Konsulencës;

d) “Angazhimi i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës” do të thotë kontributi financiar i ofruar nga MTT-ja për Koston e Shërbimeve;

e) “Konsulenti” do të thotë pala e cila do të realizojë Shërbimet;

f) Kontrata e Konsulencës” do të thotë marrëveshja që do të vendoset midis MTT-së dhe Konsulentit për realizimin e Shërbimeve;

g) “Vendi i detyrës” është Shqipëria;

h) “Donatori” do të thotë ofruesi i fondeve Grant, siç edhe specifikohet në hyrjen e kësaj Marrëveshjeje;

i) “Grant” do të thotë shuma e fondeve të vëna në dispozicion nga Dhuruesi për Bankën, si administrator, për qëllimet e financimit të Kontratës së Konsulencës;

j) “Marrëveshja e Grantit” do të thotë kjo Marrëveshje dhe të gjitha shtojcat bashkëlidhur, duke pasur parasysh se ajo mund të redaktohet herë pas here;

k) “Shuma Maksimale e Kontratës” do të thotë shuma deri në 149,117.00 euro, e cila duhet t’i paguhet Konsulentit sipas një kontrate konsulence, duke përfshirë të gjitha tarifrat, kuotat dhe shpenzimet;

l) “Drejtuuesi i Operacionit” do të thotë anëtar i stafit të Bankës, i cili është përgjegjës për monitorimin e implementimit të Kontratës së Konsulencës në emër të Bankës;

m) “Marrësi” do të thotë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave;

n) “Shërbimet” do të thotë shërbimet e realizuara nga Konsulenti për MTT-në, siç përcaktohet në Kontratën e Konsulencës.

1.02 Interpretimi

a) Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e saj.

b) Në këtë Marrëveshje, referencë në një akt është për atë akt dhe për rregullat e përcaktuara sipas atij akti, duke qenë se ai akt dhe rregullat mund të amendohen ose të modifikohen në çdo kohë, si edhe ndaj çdo akti ose rregulli që mund të miratohet dhe që ka efekt plotësues ose zëvendësues për atë akt apo rregull.

c) Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj çdo gjinie përfshin referencën ndaj të gjitha gjinive të tjera, numri njëjës përfshin shumësin dhe e anasjella, dhe referencat ndaj personave përfshijnë korporatat, shoqëritë jo të inkuorporuara dhe partneritetet. Referenca ndaj një personi përfshin pasuesit dhe personat të cilëve iu janë kaluar të drejtat.



Neni 2 Granti

2.01 Granti

a) Banka bie dakord të vendosë në dispozicion të Marrësit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, Grantin në shumën e cila nuk e kalon vlerën prej 149,117.00 euro apo ekuivalenten e saj.

b) Granti do të aplikohet vetëm për të financuar Shërbimet gjatë periudhës së angazhimit të Konsulentit.

2.02 Pagesa

a) Marrësi dhe Banka bien dakord që Banka është e autorizuar ta paguajë Konsulentin direkt në emër të MII-së.

b) Shuma e Grantit do t'i paguhet Konsulentit direkt nga Banka, në emër të dhe sipas udhëzimeve të MII-së, në përputhje me dispozitat në Kontratën e Konsulencës.

c) Sapo të merret fatura dhe dokumentet mbështetëse të dërguara nga Konsulenti në përputhje me parashikimet e Kontratës së Konsulencës, MII-ja do të kontrollojë dhe do të verifikojë sa më shpejt të jetë e nevojshme faturën dhe përmbushjen e kënaqshme të atyre Shërbimeve të Konsulentit me të cilat lidhet fatura.

d) Nëse Shërbimet rezultojnë të jenë të kënaqshme dhe MII-ja është e kënaqur me faktin se shumata e tarifuar në faturë korrespondojnë me shumata e përcaktuara në Kontratën e Konsulencës, atëherë fatura, e cila është në mbështetje të dokumenteve dhe një deklaratë (siç përcaktohet në shtojcën A të Marrëveshjes së Grantit), e cila certifikon miratimin e Shërbimeve, duhet t'i dërgohet Bankës për të bërë pagesën në *Bank's Tirana Resident Office*, ndërtesa "Torre Drin", kati i 4-t, rruga "Abdi Toptani", Tiranë, Shqipëri.

2.03 Taksat dhe detyrat

a) MII-ja bie dakord që fondet e Grantit të mos përdoren për të paguar taksat indirekte (duke përfshirë TVSH-në) të lidhura me Shërbimet apo me këtë Marrëveshje Granti të përcaktuar sipas ligjeve dhe rregullave, të cilat janë në fuqi në vendin e detyrës.

b) MII-ja do ta këshillojë Bankën nëse ndonjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) është e tarifueshme në përputhje me Kontratën e Konsulencës.

c) MII-ja bie dakord se çdo taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) e pagueshme do t'i paguhet Konsulentit nga MII-ja.

d) Nëse ndonjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) është e tarifueshme, në momentin kur Bankës i dërgohet vërtetimi sipas klauzolës 2.02/d, edhe MII-ja duhet të vërtetojë pagesën e vet të bërë për taksat indirekte (duke përfshirë TVSH-në) të pagueshme në cilëndo faturë të mëparshme të Konsulentit dhe, gjithashtu, të marrë përsipër të paguajë taksën indirekte (duke përfshirë TVSH-në) në faturën aktuale.

e) Nëse MII-ja nuk paguan ndonjë nga taksat indirekte (duke përfshirë TVSH-në), kjo Marrëveshje mund të ndërpritet sipas klauzolës 5.03.

Neni 3 Zbatimi i Projektit

3.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

a) Banka dhe MII-ja duhet të bashkëpunojnë plotësisht për sa i përket administrimit të Kontratës së Konsulencës.

Herë pas here, bazuar në kërkesën e ndonjërës prej tyre, Banka, Marrësi dhe MII-ja do të shkëmbejnë mendimet në lidhje me progresin e Projektit, Shërbimeve, qëllimeve për të cilat jepet ky Grant, përmbushjen e detyrimeve që ka MII-ja në përputhje me këtë Marrëveshje, dhe përmbushjen e detyrimeve që ka MII-ja dhe Konsulenti bazuar në Kontratën e Konsulencës, si edhe t'i sigurojë palës tjetër të gjitha informacionet e nevojshme bazuar në kërkesën e kësaj pale.

b) MII-ja duhet të informojë menjëherë Bankën për çdo ndryshim të propozuar për natyrën dhe qëllimin e Projektit apo të Shërbimeve, apo biznesit ose operacioneve të MII-së dhe të çdo zhvillimi apo kushti, i cili mund të ndikojë materialisht mbarëvajtjen e Projektit, apo të Shërbimeve, apo të biznesit ose të operacioneve të MII-së.

c) Pa cenuar tërësinë e sa më sipër, MII-ja nuk duhet të bëjë ndryshime materiale, duke përfshirë këtu edhe ndonjë vendim që lidhet me detyrën dhe nënkontraktimin në Kontratën e Konsulencës, pa marrë fillimisht pëlqimin me shkrim të Bankës, pëlqim i cili nuk mund të kundërshtohet pa pasur arsye. Në çfarëdo rasti, Banka duhet të njoftohet nga MII-ja për të gjitha ndryshimet në Kontratën e Konsulencës.



3.02 Relacione dhe raporte

a) MTI-ja duhet:

i) të kujdeset për mbarëvajtjen e procedurave dhe të relacioneve, të përshtatshme për regjistrimin dhe monitorimin e progresit të Shërbimeve (duke përfshirë kostot dhe përfitimet, të cilat burojnë prej tyre), si edhe të identifikojë Shërbimet e financuara nga Granti, dhe t'i ketë të disponueshme këto relacione për përfaqësuesit e Bankës sipas kërkesës së vet Bankës;

ii) të kujdeset për mbarëvajtjen e llogarive dhe të vërtetimeve financiare (bilancet, vërtetimet e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe vërtetime të tjera të lidhura me to), të cilat janë të nevojshme për të monitoruar dhe për të regjistruar progresin e Shërbimeve, duke përfshirë kostot dhe përfitimet të cilat burojnë nga këto Shërbime, si edhe të pajisë Bankën sipas kërkesave të saj me kopje të këtyre informacioneve, me të gjitha detajet sipas kërkesës së Bankës;

iii) t'iu bëjë të mundur përfaqësuesve të Bankës, sipas kërkesës së Bankës, të kontrollojnë çdo mjet të përfshirë apo të përmendur në Projekt, apo në Kontratën e Konsulencës, si edhe të kontrollojnë Shërbimet e financuara nga Granti, si edhe çdo impiant, instalim, vend, punim, ndërtesë, pronë, pajisje, relacion dhe dokument të lidhur me përmbushjen e detyrimeve të MTI-së apo të Konsulentit, në përputhje me këtë Marrëveshje apo Kontratë Konsulente;

iv) të pajisë përfaqësuesit e Bankës me informacione të tilla, sipas kërkesës së Bankës, në lidhje me Projektin dhe Shërbimet, koston e tyre, dhe kur të jetë e përshtatshme, me përfitimet që priten të burojnë prej tyre, si edhe me shpenzimin e të ardhurave të Grantit.

v) të pajisë ose të mundësojë pajisjen e përfaqësuesve të Bankës me planet, specifikat, raportet, kontratat, dokumentet (duke përfshirë rezultatet në përputhje me Kontratën e Konsulencës), si edhe modifikimit apo shtesat në çdo material, sipas kërkesave të Bankës.

b) Menjëherë pas përmbushjes së Shërbimeve, MTI-ja duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë Bankës një raport me një gjuhë të detajuar, me shtrirje dhe me detaje të tilla që përputhen me kërkesat e arsyeshme të Bankës, në lidhje me zbatimin dhe mbarëvajtjen e Shërbimeve, me koston dhe me përfitimet e marra prej tyre, si edhe në lidhje me përmbushjen e detyrimeve respektive nga ana e

MTI-së, Konsulentit dhe të Bankës, në përputhje me Marrëveshjen e Grantit dhe Kontratën e Konsulencës, sipas rastit.

c) Të gjitha raportet dhe relacionet e përgatitura nga MTI-ja duhet të hartohen në Microsoft Word dhe/ose në Excel, të jenë të konvertueshme në Acrobat dhe të dorëzohen në formë dokumenti dhe në formë elektronike.

3.03 Konfidencialiteti

Përveç rasteve kur është dhënë pëlqimi paraprak me shkrim i Bankës, MTI-ja dhe Marrësi nuk duhet të zbulojnë apo të lejojnë që agjentët e tyre apo nënkontraktorët t'u zbulojnë palëve të treta, dhe as të përdorin për qëllimet e tyre, çfarëdolloj informacioni në lidhje me Shërbimet, Projektin apo Bankën, duke përfshirë informacione në lidhje me Kontratën e Konsulencës. MTI-ja dhe Marrësi mund të ofrojnë të dhëna dhe informacione të tilla, nëse kërkohet nga ligji apo rregullorja në fuqi, por vetëm ajo pjesë e informacionit, e cila me aq sa lejon ligji apo rregullorja respektive, kërkohet ligjërisht që të ofrohet. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, MTI-ja dhe Marrësi duhet të informojnë menjëherë Bankën.

3.04 Drejtimi i operacioneve

Nëse Banka nuk ka mendim tjetër, atëherë MTI-ja duhet të drejtojë biznesin dhe operacionet e saj (duke përfshirë edhe operacionet për çdo degë), në përputhje me standardet dhe praktikat administrative, teknike, financiare dhe mjedisore, të njohura ndërkombëtarisht, nën mbikëqyrjen e një menaxhimi të kualifikuar dhe me eksperiencë, të asistuar nga një staf kompetent dhe të mjaftueshëm.

3.05 Mbështetja e Marrësit

Marrësi duhet:

i) të përmbushë siç duhet detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje;

ii) të mbështesë MTI-në të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë ndërmarrjen e të gjitha masave legjislative e rregulluese apo të masave të tjera të nevojshme apo të dëshirueshme, si edhe duke përcaktuar apo duke mundësuar sigurimin e fondeve dhe mbështetjes për MTI-në, kur këto t'i nevojiten MTI-së për të realizuar Projektin; dhe

iii) të ndërmarë çdo masë, në përputhje me ligjin shqiptar për ta vënë këtë Marrëveshje në zbatim.



Neni 4 Përfaqësimi

4.01 Përfaqësuesi i autorizuar

Çdo masë e kërkuar apo e lejuar për t'u ndërmarrë, si edhe çdo akt i kërkuar apo i lejuar që të zbatohet, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të ndërmerret ose do të zbatohet:

- a) në emër të marrësit nga z. Shkëlqim Cani apo nga një përfaqësues i emëruar; dhe
- b) në emër të MTT-së nga z. Edmond Haxhinasto apo nga një përfaqësues i emëruar; dhe
- c) në emër të Bankës nga drejtori, Bashkëpunimi Teknik apo nga cilido përfaqësues i autorizuar i Bankës.

4.02 Njoftime ose kërkesa

Çdo njoftim, kërkesë apo miratim i kërkuar apo i lejuar për t'u dhënë apo për t'u bërë, në përputhje me këtë Marrëveshje, duhet të hartohet me shkrim në gjuhën angleze. Çdo njoftim, kërkesë apo miratim do të konsiderohet si i dhënë apo i bërë kur dorëzohet personalisht te përfaqësuesi i autorizuar i palës së cilës i adresohet komunikimi, ose kur dërgohet me postë të regjistruar apo me faks palës në adresën e mëposhtme:

Për Marrësin:
Për z. Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Adresa: Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Shqipëri
Telefon: + 355 4 2234647
Faks: + 355 4 2228494

Për MTT-në:
Për z. Edmond Haxhinasto
Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës
Adresa: Ministria e Transportit dhe
Infrastrukturës
Sheshi "Skënderbej", nr. 5
Tiranë
Shqipëri
Telefon: + 355 4 2234647

Për Bankën:
Për Raphael Rashid
Drejtuuesi i Operacionit
Adresa: European Bank for Reconstruction and
Development
One Exchange Square London EC2A 2 JN,

Mbretëria e Bashkuar
Telefon: +44 20 7338 6581
Email: rashidr@ebrd.com

a) Njoftimi do të konsiderohet në fuqi, për sa më poshtë:

- i) në rast të dorëzimit personalisht apo më anë të postës së regjistruar për shpërndarjen; dhe
- ii) në rast të fakseve, të cilat ndjekin transmetimin e konfirmuar.

b) Një palë mund ta ndryshojë adresën për dorëzimin e njoftimeve apo të kërkesave, duke njoftuar palën tjetër në përputhje me këtë klauzolë.

Neni 5 Pezullimi dhe ndërprerja

5.01 Njoftim i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës

MTI -ja duhet të njoftojë menjëherë Bankën për pezullimin apo për ndërprerjen e Kontratës së Konsulencës, apo për çdo zhvillim, i cili mund të çojë në pezullimin apo ndërprerjen e Kontratës së Konsulencës.

5.02 Pezullimi i pagesave

Nëse ndodh një nga zhvillimet e mëposhtme dhe ky i fundit ndodh që të jetë në vazhdimësi, Banka, me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Marrësit, pezullon menjëherë pagesën për Konsulentin, pjesërisht ose plotësisht, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje:

- a) nëse pezullohet Kontrata e Konsulencës ose nëse Kontrata e Konsulencës ndërpritet, në përputhje me kushtet e Kontratës së Konsulencës;
- b) nëse MTT-ja nuk ka paguar taksat indirekte (duke përfshirë edhe TVSH-në) për faturat e Konsulentëve për Konsulentin në kohën e duhur, në përputhje me kushtet e Kontratës së Konsulencës;

c) Nëse ka pasur ndonjë rrethanë tjetër, e cila sipas opinionit të arsyeshëm të Bankës, ndërhyt ose kërcënon të ndërhyjë në mbarëvajtjen e suksesshme të Shërbimeve apo të Projektit, ose në përmbushjen e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

5.03 Ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje nga Banka

a) Me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Marrësit, Banka mund ta ndërpresë këtë Marrëveshjeje, nëse:

- i) ndonjë nga kushtet e përmendura në klauzolën 5.02, vazhdon për një periudhë prej 30



(tridhjetë) ditësh, pasi Banka ka pezulluar, plotësisht apo pjesërisht, pagesat për Konsulentin dhe ka njoftuar me shkrim Marrësin; ose

ii) Kontratës së Konsulencës i ka mbaruar afati ose është ndërprerë në përputhje me kushtet; ose

iii) Marrësi dhe Banka bien dakord ta ndërpresin atë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje; ose

iv) Dhuruesi pezullon financimin e Grantit; ose

v) prokurimi i ndonjërit prej Shërbimeve është i papajtueshëm me këtë Marrëveshje; ose

vi) fondet e paguara sipas kësaj Marrëveshjeje janë përdorur për qëllime të tjera nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje.

b) Për çdo zhvillim, Banka mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo moment, duke njoftuar fillimisht me shkrim Marrësin në një periudhë kohore jo më pak se dyzet ditë.

5.04 Procedura e ndërprerjes

Me ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje, sipas klauzolës 5.03, MTI-ja do të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të reduktuar humbjet dhe për t'i mbajtur në minimum shpenzimet e tjera, sipas Kontratës së Konsulencës.

Neni 6

Të përgjithshme

6.01 Përfundimi i detyrimeve

Pavarësisht çdo dispozite tjetër në këtë Marrëveshje, Banka nuk është përgjegjëse ndaj Marrësit, MTI-së apo Konsulentit sipas apo në lidhje me këtë Marrëveshje apo Kontratës së Konsulencës, për humbjet apo dëmet, edhe pse ato janë shkaktuar ose nuk janë shkaktuar nga neglizhenca apo pakujdesia e Bankës. Kjo dispozitë nuk është e zbatueshme në rastin kur neglizhenca apo pakujdesia e Bankës shkakton vdekjen apo dëmtimin personal të MTI-së, apo të personelit të Konsulentit apo të Ekspertëve.

6.02 Zhdëmtimi

MTI-ja zhdëmton, dhe sipas privilegjeve dhe imuniteteve të Bankës, mbron Bankën, drejtorët, oficerët, punonjësit, agjentët dhe kontraktuesit e saj ndaj të gjitha kërkesave, dëmeve, kostove, shpenzimeve, detyrimeve, masave, humbjeve, të cilat lindin nga, kanë lidhje ose jo me çfarëdo veprimi ose pakujdesie nga ana e MTI-së apo Konsulentit, punonjësve, nënkontraktorëve apo agjentëve të tyre, edhe nëse ai mund të jetë i tërthortë, neglizhent apo i ndonjë forme tjetër, ose

ndonjë shkelje prej tyre ndaj detyrimeve që ata kanë sipas kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës; apo çdo pamundësie nga ana e tyre për t'iu përmbajtur akteve, rregullave apo normave.

6.03 Praktikë e ndaluar

Banka, pa ndonjë paragjykim për çdo kompensim për shkelje të Marrëveshjes, mund ta ndërpresë menjëherë këtë Marrëveshje nëse Marrësi dhe/ose MTI-ja, sipas gjykimit të Bankës, janë përfshirë në praktika të ndaluara gjatë konkurrencës për Kontratën e Konsulencës apo gjatë zbatimit të saj.

“Praktikë e korruptuar” do të thotë të ofrosh, të japësh, të marrësh apo të kërkosh në mënyrë direkte apo indirekte çdo gjë me një vlerë të tillë që mund të ndikojë në mënyrën e gabuar në veprimet e një pale tjetër në lidhje me procesin e përzgjedhjes apo në zbatimin e Kontratës në mënyrë që të sigurojë apo të ruajë biznesin apo ndonjë avantazh tjetër të papërshtatshëm në administrimin e biznesit.

“Praktikë mashtruese” do të thotë çdo veprim apo pakujdesi, duke përfshirë edhe një keqpërfaqësim, i cili me qëllim apo për pakujdesi mund të mashtrrojë një palë që kjo e fundit të sigurojë një përfitim financiar apo një përfitim të një natyre tjetër apo të shmangë një detyrim.

“Praktikë detyruese” do të thotë të përkeqësosh apo të dëmtosh, apo të kërcënosh, të përkeqësosh ose të dëmtosh në mënyrë direkte ose indirekte, cilëndo palë apo pronë të palës, për të ndikuar negativisht në veprimet e palës për sa ka të bëjë me procesin përzgjedhës apo me zbatimin e Kontratës, në mënyrë që të përvetësosh apo të ruash biznesin apo ndonjë avantazh tjetër të papërshtatshëm gjatë administrimit të biznesit.

“Praktikë e fshehtë dhe mashtruese” do të thotë një marrëveshje midis dy ose më shumë palëve me qëllimin për të përmbushur një objektiv të gabuar, duke përfshirë edhe ndikimin e keq në veprimet e një pale tjetër dhe përfshin çdo marrëveshje midis konsulentëve (përpara apo pas dorëzimit të propozimeve), me synimin për të përcaktuar çmime në nivele artificiale jokonkurreuese dhe për të privuar MTI-në nga përfitimet e konkurrencës së lirë dhe të hapur.

6.04 Inspektimi dhe auditimi nga Banka

MTI-ja duhet të lejojë Bankën ose përfaqësuesin e saj të autorizuar të inspektojë llogaritë dhe të dhënat e saj në lidhje me përmbushjen e kësaj



Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës dhe Shërbimeve, si edhe të lejojë auditimin e këtyre llogarive nga auditët e caktuar nga Banka, nëse një gjë e tillë kërkohet nga Banka.

6.05 Sigurimet

Të pazbatueshme.

6.06 Ligji drejtues dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Kjo Marrëveshje interpretohet në përputhje me ligjet angleze. Çdo detyrim jokontraktual, i cili paraqitet jashtë apo në përputhje me këtë Marrëveshje, administrohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet angleze.

b) Çdo mosmarrëveshje apo pretendim, i cili lind nga kjo Marrëveshje apo në lidhje me të, apo nga shkelja, ndërprerja apo shfuqizimi, apo çdo detyrim jokontraktual, që lind nga kjo Marrëveshje apo në lidhje me të, i cili nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore, zgjidhet me anë të arbitrazhit në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL, të cilat janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje. Duhet të jetë 1 (një) arbitër, ndërsa autoriteti emëruar për qëllimet e Rregullave të UNCITRAL-it (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Ligjet Tregtare Ndërkombëtare - KKBLTN) duhet të jetë Gjykata Londineze e Arbitrazhit Ndërkombëtar (GJLAN). Vendi i arbitrazhit duhet të jetë Londra, Angli dhe gjuha angleze duhet të përdoret gjatë gjithë procedurave arbitrare. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë sipas Aktit të Arbitrazhit, i vitit 1996, ose në të kundërt ato duhet të apelojnë për arbitrazh apo të kërkojnë përcaktimin e një ligji paraprak nga gjykatat e Anglisë apo diku tjetër. Arbitri nuk është i autorizuar të ndërmarrë masa të përkohshme ndaj Bankës, pavarësisht dispozitave të Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL-it (KKBLTN) dhe MTI-ja duhet të bjerë dakord se nuk do t'i kërkojë ato nga asnjë autoritet gjyqësor.

c) Asnjë element në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet si dorëheqje, tërheqje apo modifikim nga ana e Bankës në lidhje me imunitetet, privilegjet apo përjashtimet e Bankës sipas Marrëveshjes për Ndërtimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, sipas Konventës Ndërkombëtare apo çdo ligji të zbatueshëm. Pavarësisht nga sa më sipër, Banka ka bërë një kërkesë të posaçme për arbitrazh

sipas seksionit 6.06/b të kësaj Marrëveshjeje, dhe në përputhje dhe pa paramenduar për privilegjet dhe imunitetet e saj (duke përfshirë, pa limit paprekshmërinë e arkivave të saj), ajo pranon se nuk ka imunitet ndaj procesit gjyqësor, sipas nenit 5(2) të Instrumentit të Statutit 1991 nr. 757 (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Imunitetet dhe privilegjet”) urdhri 1991) apo ndonjë dispozite tjetër sipas ligjeve angleze, në lidhje me zbatimin e një vendimi arbitrazhi kundër saj, si rezultat i kërkesës së saj të posaçme për arbitrazh në zbatim të seksionit 6.06/b të kësaj Marrëveshjeje.

6.07 Efikasiteti

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi sapo të përfundojnë procedurat e brendshme për hyrjen e saj në fuqi, në përputhje me ligjin shqiptar dhe, nëse nuk pezullohet apo ndërpritet në përputhje me nenin 5, dhe mbetet në fuqi derisa të plotësohen Shërbimet dhe të gjitha pagesat sipas Kontratës së Konsulencës.

6.08 Amendimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të amendohet vetëm me mirëkuptimin me shkrim midis Bankës dhe Marrësit, i zbatuar sipas rregullave nga përfaqësuesit e autorizuar.

6.09 E gjithë Marrëveshja

Kjo Marrëveshje, së bashku me të gjitha shtojcat bashkëngjitur, e amenduar herë pas here në përputhje me klauzolën 6.08, përmban të gjithë arsyetimin dhe marrëveshjen midis palëve dhe pezullon të gjitha propozimet apo marrëveshjet e tjera në lidhje me subjektin e kësaj Marrëveshjeje. Asnjë palë nuk mbështetet në sipërmarrjen apo përfaqësimin nga ndonjë pale tjetër, e cila nuk është pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

6.10 Pasuesit

Kjo Marrëveshje lidhet dhe hyn në zbatim për përfitimet e pasuesve respektivë dhe të personave të cilëve iu janë kaluar të drejtat e palëve.

6.11 Përjashtimi i të drejtave të Palëve të Treta

Kjo Marrëveshje nuk krijon ndonjë të drejtë sipas Aktit të Kontratave (“Të drejtat e palëve të treta”) 1999, e zbatueshme nga persona apo entitete, të cilët nuk janë palë me të, me përjashtim të rastit kur një entitet apo person, i cili është pasues ose të cilit i janë kaluar të drejtat e një pale, mendohet të jetë palë me këtë Marrëveshje.



6.12 Klauzolat që mbeten në fuqi
Klauzolat 3.03, 6.01, 6.02, 6.03, 6.04 dhe 6.06 do t'i mbijetojnë ndërprerjes apo mbarimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje.

6.13 Gjuha

Anglishtja është gjuha e Marrëveshjes. I gjithë komunikimi, dokumentacioni dhe raportet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës së Konsulencës duhet të përgatiten dhe prezantohen në gjuhën angleze. Gjatë çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me gjuhën, mbizotëron versioni i anglishtes.

6.14 Garanci të tjera

Herë pas here, me kërkesën e Bankës, MTT-ja duhet të angazhohet vetë ose të angazhojë Konsulentin, të përmbushë dhe të shpërmdajë dokumente të tjera, si edhe të bëjë këto akte të tjera në përputhje me kërkesat e arsyeshme të Bankës, në mënyrë që të tregojë, të drejtojë dhe t'i japë efekt të plotë ligjor kushteve, qëllimit dhe domethënies së kësaj Marrëveshjeje.

6.15 Respektimi i afateve

E pazbatueshme.

6.16 Kopjet origjinale të Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të përgatitet në tri kopje, secila duhet t'i përmbahet një dhe së njëjtës Marrëveshjeje.

6.17 Logoja e BERZH-it

MTT-ja dhe Marrësi informohen se logoja e Bankës është një simbol i regjistruar shërbimi; dhe as MTT-ja dhe as Marrësi nuk mund ta riprodhojnë një logo të tillë pa lejen e posaçme me shkrim të Bankës.

Në prani të dëshmitarëve, palët, me anë të përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë firmosur këtë Marrëveshje në tri kopje, në gjuhën angleze, në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

PËR DHE NË EMËR TË MARRËSIT:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,
përfaqësuar nga Ministri i Financave

.....

Shkëlqim Cani

Ministër i Financave

Ministria e Financave

Data:

PËR DHE NË EMËR TË BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM:

Stephen Gillard

Kryekëshilltar

Bashkëpunim Teknik

Datë:

SHTOJCA A

FORMULARI I DEKLARATËS PËR
MIRATIMIN E SHËRBIMEVE TË
KONSULENCËS

SHTOJCA A PËR MARRËVESHJEN E
GRANTIT

FORMULARI I DEKLARATËS PËR
MIRATIMIN E SHËRBIMEVE TË
KONSULENCËS

Të firmoset nga Ministria e Transportit dhe
Infrastrukturës dhe të dërgohet nga Konsulenti me
faturat për Shërbimet.

Fatura nr. Data e Faturës:

Shuma e Faturës:

Marrëveshja e Grantit Nr: C26374/EBSF-2011-
10-161 OL: Raphael Rashid

1. Në vijim të Kontratës së Konsulencës për
Strategjinë e Taksimit Rrugor në Shqipëri
ë“Shërbimet”], në datën _____,
midis Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës
ë“MTT”] dhe ë“Konsulenti”]; dhe në vijim të
klauzolës 2.02(d) të Marrëveshjes së Grantit për
Shërbimet, më datë xxxxxx, ndërmjet Bankës
Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ë“Banka”]
dhe Marrësit, MTT-ja pohon se:

i) MTT-ja ka marrë dhe është e kënaqur me
Shërbimet e Konsulentit, për të cilat është
kontraktuar në Kontratën e Konsulencës,
Shërbime të cilat mbulohen nga faturat
bashkëlidhur;

ii) MTT-ja ka kontrolluar faturat dhe të gjitha
dokumentet mbështetëse, të cilat kanë lidhje me
përmbushjen e Shërbimeve kundrejt shumave të
përcaktuara në Kontratën e Konsulencës dhe
siguron se:

a) Fatura/faturat është/janë një pasqyrim i
vërtetë i Shërbimeve të ofruara nga Konsulenti; dhe



b) Shuma/shumat e/të tarifuar/a në faturë/a korrespondon/jnë me shumën/shumat e përcaktuar/a në Kontratën e Konsulencës;

iii) fatura/t dhe të gjitha dokumentet mbështetëse janë dërguar së bashku me këtë Deklaratë për Miratim adresuar Skuadrës së Faturimit TC, Njësia e Kontrollit të Faturave të Bankës për pagesën; dhe

iv) MTI-ja ka paguar çdo taksë indirekte duke përfshirë TVSH -në për Konsulentin sipas faturave të mëparshme dhe merr përsipër të paguajë faturat indirekte duke përfshirë TVSH-në në lidhje me faturën/faturat bashkëlidhur brenda 30 ditëve nga data e kësaj deklarate miratimi.

2. MTI-ja pohon se duke nënshkruar këtë dokument, MTI-ja autorizon Bankën të bëjë pagesën e Konsulentit, për të cilën është rënë dakord në Kontratën e Konsulencës, në emër të MTI-së.

Në prani të dëshmitarëve, pala, me anë të përfaqësuesit të saj të autorizuar ka nënshkruar këtë kontratë, më [data].

PËR DHE NË EMËR TË
Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës

LIGJ
Nr. 42/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE DUKATIT TË MADH
TË LUKSEMBURGUT PËR MBROJTJEN
SHOQËRORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.4.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9065, datë 28.4.2015,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE
PËR MBROJTJEN SHOQËRORE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE DUKATIT TË MADH TË
LUKSEMBURGUT

Republika e Shqipërisë dhe Dukati i Madh i Luksemburgut, më poshtë do të quhen “Shtete kontraktuese” për rregullimin e marrëdhënieve reciproke midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes shoqërore, kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

1. Me qëllim zbatimin e Marrëveshjes së mëposhtme, termi:

a) “Legjislacion” nënkupton ligjet, aktet nënligjore, rregulloret dhe dispozitat statutoare për mbrojtjen shoqërore, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 2;

b) “Autoritet kompetent” nënkupton respektivisht për secilin shtet kontraktues, ministrin, ministrat ose një autoritet tjetër nga të cilat varen legjislacionet e mbrojtjes shoqërore, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 2;

c) “Institucion kompetent” nënkupton organin ose autoritetin përgjegjës për zbatimin e plotë ose të pjesshëm të legjislacionit, të përcaktuar në pikën 1, të nenit 2;

d) “Periudhat e sigurimit” nënkuptojnë periudhat e pagesës së kontributeve ose periudhat e punësimit ose të vetëpunësimit, të përcaktuara ose të pranuar si të tilla nga legjislacioni, sipas të cilit janë plotësuar ose të konsideruara si të plotësuar, si dhe të gjitha periudhat e njohura nga ky legjislacion si ekuivalente të periudhave të sigurimit;



e) “Përfitim” nënkupton të gjitha pensionet dhe përfitimet në para, përfshirë këtu elementet e parashikuara nga legjislacionet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 2.

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që iu është dhënë në legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për legjislacionin që ka të bëjë me:

A. Në Republikën e Shqipërisë:

1) Skemën e sigurimeve të detyrueshme shoqërore për pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

2) Sigurimin vullnetar të kujdesit shëndetësor në zbatim të nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje.

B. Në Dukatën e Madh të Luksemburgut:

1) Sigurimin për pensionet në rast pleqërie, invaliditetin dhe familjare;

2) Pikën 1, të nenit 2, të Kodit të Mbrojtjes Sociale në zbatim të nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Pavarësisht nga parashikimet në pikën 1 më sipër, dispozitat e pjesës II të kësaj Marrëveshjeje zbatohen:

A. Në Republikën e Shqipërisë, për degët e tjera të sigurimit të detyrueshëm, si më poshtëshënuar:

1) Barrë lindje;

2) Sëmundjet;

3) Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;

4) Papunësinë;

5) Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

B. Në Dukatën e Madh të Luksemburgut:

1) Sigurimi i sëmundjes – barrë lindjes;

2) Sigurimi i aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;

3) Sigurimi i të punësuarve;

4) Përfitimet e papunësisë;

5) Përfitimet familjare.

3. Kjo Marrëveshje zbatohet, gjithashtu, për të gjitha aktet ligjore apo rregulloret që modifikojnë, plotësojnë ose kodifikojnë legjislacionet e specifikuar në pikën 1.

4. Kjo Marrëveshje zbatohet për çdo akt ligjor të një shteti kontraktues, i cili zgjeron legjislacionet e referuara në pikën 1 për kategori të reja

përfituesish, nëse në një kohëzgjatje prej 6 muajsh nga publikimi zyrtar i këtyre akteve, ky shtet kontraktues nuk i bën të ditur specifikisht shtetit tjetër kontraktues që marrëveshja nuk vlen për këtë kategori të re.

5. Kjo Marrëveshje zbatohet për aktet ligjore të një dege të re të sigurimeve shoqërore, vetëm nëse për këto bihet dakord mes autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

6. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për përfitimet e asistencës sociale dhe përfitimet në favor të viktimave të luftës.

Neni 3

Fusha e veprimit sipas personave

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për personat që janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të një shteti kontraktues, për persona të tjerë që përfitojnë të drejtat që rrjedhin prej këtyre personave.

Neni 4

Trajtimi i barabartë

Personat që banojnë në territorin e një shteti kontraktues dhe për të cilët zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, u nënshtrohen detyrimeve dhe përfitojnë nga legjislacionet e referuara në nenin 2, me të njëjtat kushte, si dhe shtetasit e këtij shteti kontraktues.

Neni 5

Heqja e dispozitës së qëndrimit

Përfitimet sipas legjislacionit të një shteti kontraktues nuk mund të reduktohen, të modifikohen, të pezullohen apo të anulohen nga fakti që përfituesi banon në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

Neni 6

Bashkimi i periudhave të sigurimit

Nëse legjislacioni i një shteti kontraktues kushtëzon dhënien, mbajtjen ose zëvendësimin e përfitimeve me plotësimin e një periudhe sigurimi, institucioni kompetent i këtij shteti kontraktues merr parasysh periudhat e sigurimit, të plotësuara sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, me kusht që këto periudha të mos mbivendosen.



Neni 7

Pranimi i ndërsjellë i rasteve

1. Në rastin kur në zbatim të legjislacionit të shtetit kontraktues kompetent, marrja e përfitimit ose e të ardhurave të tjera prodhon pasoja juridike, dispozitat përkatëse të legjislacionit në fjalë zbatohen, gjithashtu, për përfitimet ekuivalente, të marra në zbatim të legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues ose për të ardhura të marra në shtetin tjetër kontraktues.

2. Nëse sipas legjislacionit të shtetit kontraktues kompetent, pasojat juridike që janë shkaktuar nga fakte apo ngjarje të caktuara, ky shtet kontraktues konsideron faktet dhe ngjarjet e ngjashme të ndodhura në shtetin tjetër kontraktues sikur të kishin ndodhur në territorin e vet.

3. Dispozitat e pikës 2, nuk zbatohen as në rastet e njohjes së invaliditetit për të cilën vetëm legjislacioni i shtetit përkatës është i zbatueshëm dhe as për pranimin e periudhave të sigurimit, të cilat bashkohen sipas nevojës, në përputhje me dispozitat e neneve 6 dhe 14.

Neni 8

Pranimi në sigurimin shëndetësor të vazhdueshëm vullnetar

1. Nëse legjislacioni i një shteti kontraktues kushtëzon pranimin e sigurimit shëndetësor vullnetar të vazhdueshëm, në bazë të rezidencës në territorin e shtetit kontraktues, personat që janë rezidentë në territorin e shtetit tjetër kontraktues kanë të drejtën e sigurimit shëndetësor vullnetar të vazhdueshëm, me kusht që këta persona të kenë punuar në shtetin e parë kontraktues, në çfarëdo periudhe të mëparshme.

2. Nëse legjislacioni i një shteti kontraktues kushtëzon pranimin e sigurimit shëndetësor vullnetar të vazhdueshëm me plotësimin e periudhave të sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, konsiderohen në masën e nevojshme, si periudha sigurimi të përmbushura në shtetin e parë kontraktues.

PJESA II

**DISPOZITA QË PËRCAKTOJNË
LEGJISLACIONIN E ZBATUESHËM**

Neni 9

Rregulla të përgjithshme

1. Personat e punësuar ose të vetëpunësuar në territorin e një shteti kontraktues i nënshtrohen legjislacionit të këtij shteti kontraktues edhe nëse banojnë në territorin e shtetit tjetër kontraktues ose nëse punëdhënësi që i ka punësuar e ka selinë e tij në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

2. Anëtarët e personelit të një anijeje që mban flamurin e një shteti kontraktues i nënshtrohen legjislacionit të këtij shteti kontraktues.

3. Nëpunësit publikë dhe personeli ekuivalent me ta i nënshtrohen legjislacionit të shtetit kontraktues për të cilin ata punojnë.

Neni 10

Dispozita të veçanta

1. Personat e punësuar në territorin e një shteti kontraktues, që dërgohen nga punëdhënësi për të punuar për llogari të tij në territorin e shtetit tjetër kontraktues, i nënshtrohen legjislacionit të shtetit të parë kontraktues, me kusht që kohëzgjatja e parashikuar e punës të mos i kalojë 24 muajt.

2. Personat e vetëpunësuar në territorin e një shteti kontraktues, që kryejnë një punë në territorin e shtetit tjetër kontraktues, i nënshtrohen legjislacionit të shtetit të parë kontraktues, me kusht që kohëzgjatja e parashikuar e punës të mos i kalojë 24 muajt.

Neni 11

Rregulla të veçanta për personelin e ndërmarrjeve të transportit

1. Personat që bëjnë pjesë si punonjës të një shoqërie transporti që e ka zyrën të regjistruar në njërin nga shtetet kontraktuese dhe punojnë përkohësisht në territorin e shtetit tjetër është subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues në të cilën shoqëria ka zyrën e vet të regjistruar.

2. Megjithatë, në rastin kur ndërmarrja ka në territorin e shtetit tjetër kontraktues një degë ose një përfaqësi të përhershme, personat e punësuar në këtë të fundit i nënshtrohen legjislacionit të vendit në territorin e të cilit ndodhet dega apo përfaqësia e përhershme.



Neni 12

Rregulla të veçanta për misionet diplomatike dhe zyrat konsullore

1. Personeli i shërbimit në misionet diplomatike ose në konsullata të shteteve kontraktuese dhe personeli ndihmës në shërbim të diplomatëve të vendosur në territorin e në shteti tjetër kontraktues, i nënshtrohen legjislacionit të shtetit kontraktues nga i cili janë dërguar.

2. Për personat e përcaktuar në pikën 1, që nuk janë të dërguar nga shteti që kanë përfaqësuar diplomatike, i nënshtrohen legjislacionit të shtetit kontraktues në territorin e të cilit ata punojnë, sipas pikës 1, të nenit 9. Megjithatë nëse këta persona janë shtetas të shtetit kontraktues, të përfaqësuar nga misioni diplomatik ose nga konsullata, ata mund të kërkojnë zbatimin e legjislacionit të këtij shteti kontraktues. Kjo e drejtë zgjedhjeje mund të ushtrohet vetëm një herë brenda afatit tremujor, duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje ose nga dita e fillimit të punës të personit.

Neni 13

Përrjashtimet

Autoritete kompetente të shteteve kontraktuese mund të parashikojnë me një vendim të përbashkët disa përrjashtime për dispozitat e neneve 9 deri 12, për disa persona ose disa kategori personash.

PJESA III

**PENSIONET E PLEQËRISË,
INVALIDITETIT DHE FAMILJARE**

Neni 14

Rregulla të veçanta të bashkimit të periudhave

1. Nëse legjislacioni i një shteti kontraktues kushtëzon të drejtën për përfitime me plotësimin e periudhave të sigurimit në një profesion, në një punë ose në një punësim të veçantë, i cili rregullohet me dispozita të veçanta, institucioni kompetent i këtij shteti kontraktues njeh periudhat e sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues për të njëjtën profesion, punë ose punësim të veçantë që rregullohen me dispozita të veçanta.

2. Nëse një person nuk ka të drejtë për përfitime në bazë të periudhave të sigurimit të plotësuar sipas legjislacioneve të të dyja shteteve

kontraktuese, të bashkuara sipas nenit 6, e drejta e përfitimit në fjalë, caktohet na bashkimi i këtyre periudhave me periudhat e plotësuar sipas legjislacionit të shtetit të tretë me të cilin të dyja shtetet kontraktuese kanë marrëveshje të mbrojtjes shoqërore dy- ose shumëpalëshe që parashikon rregulla të bashkimit të periudhave të sigurimit.

Neni 15

Periudha e sigurimit më pak se një vit

Kur periudhat e sigurimit të kryera sipas legjislacionit të një shteti kontraktues nuk plotësojnë një vit, asnjë përfitim nuk jepet sipas këtij legjislacioni, vetëm nëse legjislacioni parashikon shprehimisht të drejtën për përfitim. Megjithatë këto periudha merren parasysh nga shteti tjetër kontraktues për zbatimin e nenit 6, si dhe për zbatimin e nenit 17, pika 2, me përjashtim të shkronjës “c” të kësaj pike.

Neni 16

**Veçoritë e legjislacionit të Luksemburgut
(vitet e përkujdesjes për beben)**

Kur llogaritet pensioni, neni 6 i kësaj Marrëveshjeje zbatohet duke njohur periudhat e kujdesit për fëmijën të parashikuara nga legjislacioni i Luksemburgut, me kusht që ky person periudhat e fundit të sigurimit para lindjes ose birësimit të fëmijës, t'i ketë plotësuar sipas legjislacionit të Luksemburgut.

Neni 17

Llogaritja e pensioneve

1. Nëse një person ka të drejtë për një pension sipas legjislacionit të një shteti kontraktues, pa pasur nevojën për të zbatuar nenet 6 dhe 14 të kësaj Marrëveshjeje, institucioni kompetent do të llogarisë, në përputhje me legjislacionin që ai zbaton, pensionin që i korrespondon periudhave të përgjithshme të sigurimit, të konsideruara të tilla sipas këtij legjislacioni. Ky institucion do të llogarisë pensionin sipas pikës 2 të këtij neni dhe do të marrë në konsideratë shumën më të madhe.

2. Nëse një person ka të drejtë për një pension, që përfitohet vetëm me bashkimin e periudhave të sigurimit, sipas neneve 6 dhe 14, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) institucioni kompetent llogarit shumën teorike të pensionit për të cilin aplikuesi do të ketë



të drejtë, nëse të gjitha periudhat e sigurimit të përmbushura sipas legjislacioneve të të dyja shteteve kontraktuese të ishin plotësuar vetëm sipas legjislacionit të tij;

b) për të caktuar shumën teorike të përmendur në pikën “a”, llogaritja bazohet te periudhat e sigurimit të kryera sipas legjislacionit të zbatuar nga institucioni kompetent;

c) mbi bazën e shumës teorike, institucioni kompetent do të përcaktojë shumën efektive të pensionit që i takon personit në raport me periudhat e sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të tij, krahasuar me periudhat totale të sigurimit të plotësuar sipas legjislacioneve të të dyja shteteve kontraktuese.

3. Kur totali i periudhave të sigurimit, të realizuara në të dyja shtetet kontraktuese është më i madh se maksimumi i periudhës së kërkuar për pension të plotë, sipas legjislacionit të secilit shtet kontraktues, institucioni kompetent merr në konsideratë - për llogaritjen e pensionit këtë maksimum në vend të totalit të periudhave të realizuara në të dyja shtetet kontraktuese. Kjo metodë llogaritjeje nuk do të detyrojë institucionet të ofrojnë një pension më të madh se pensioni i plotë që ofrohet sipas legjislacionit të zbatuar.

4. Nëse një person ka të drejtë për një pension në bazë të dispozitave të pikës 2, të nenit 14, periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit të shtetit të tretë do të merren parasysh për zbatimin e pikës 2.

PJESA IV DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 18

Masat për zbatimin e Marrëveshjes

1. Autoritetet kompetente informojnë njëra-tjetrën për masat e marra për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha ndryshimet në legjislacionin e tyre që mund të ndikojnë në zbatimin e saj.

2. Autoritetet kompetente përcaktojnë kushtet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në një marrëveshje administrative.

3. Autoritetet kompetente në marrëveshje administrative përcaktojnë institucionet ndërlidhëse për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 19

Ndihmë e ndërsjellë administrative

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet dhe institucionet kompetente të shteteve kontraktuese shkëmbejnë mendimet dhe praktikat më të mira njëllor sikur të zbatonin legjislacionin e tyre. Ndihma e ndërsjellë administrative e këtyre autoriteteve dhe institucioneve kompetente është falas.

2. Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet dhe institucionet kompetente mund të komunikojnë direkt ndërmjet tyre, ashtu si dhe me çdo person objekt të kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht vendit të banimit.

3. Ekzaminimet mjekësore të personave që banojnë në territorin e shtetit tjetër kontraktues, kryhen nga institucioni i vendit të banimit me kërkesë dhe shpenzimet e institucionit kompetent. Kostot e ekzaminimeve mjekësore nuk kompensohen nëse ekzaminimet kryhen në interesin e institucioneve të të dyja shteteve kontraktuese.

4. Kushtet e ekzaminimeve mjekësore dhe masave administrative për përfituesit e kësaj Marrëveshjeje janë përcaktuar në marrëveshje administrative të parashikuara në pikën 2, të nenit 18.

Neni 20

Gjuha e përdorur

1. Të gjitha komunikimet për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet ose institucionet kompetente të shteteve kontraktuese shkruhen në gjuhën frënge ose në gjuhën shqipe.

2. Një kërkesë apo dokument nuk mund të refuzohet për shkak se është shkruar në gjuhën zyrtare të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 21

Përrjashtimi nga taksat dhe detyrimi për legalizimin

1. Përrjashtimi ose reduktimi i taksave për pullat, vulat, si edhe i tarifave të regjistrimit të parashikuara nga legjislacioni i një shteti kontraktues për dokumentet që duhen për zbatimin e legjislacionit të këtij shteti kontraktues shtrihen edhe për dokumentet e ngjashme që duhen për zbatimin e legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues ose të marrëveshjes në fjalë.



2. Të gjitha aktet, dokumentet që përgatiten për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje përjashtohen nga noterizimi nga ana e autoriteteve diplomatike apo konsullore.

Neni 22

Afati kohor

1. Çdo ankesë, deklaratë apo apelim që dorëzohet, në zbatim të legjislacionit të një shteti kontraktues, brenda një afati të përcaktuar, nga autoriteti ose institucioni kompetent i atij shteti, janë të pranueshme nëse ata paraqiten brenda të njëjtit afat të përcaktuar, pranë autoritetit ose institucionit kompetent të shtetit tjetër kontraktues. Në këtë rast deklarata, ankesa ose apelimi dërgohen pa vonesë tek autoriteti ose institucioni kompetent i shtetit kontraktues të parë, direkt ose përmes institucioneve ndërlidhëse.

2. Kërkesa për përfitime sipas legjislacionit të një shteti kontraktues do të konsiderohet si kërkesë e bërë për një përfitim të njëjtë sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues me përjashtim të rastit kur kërkuesi shprehimisht kërkon shtyrjen e caktimit të përfitimit të kërkuar sipas legjislacionit të një prej shteteve kontraktuese.

Neni 23

Pagesa e përfitimeve

1. Institucionet e një shteti kontraktues, që sipas kësaj Marrëveshjeje janë debitorë për përfitime ndaj përfituesve në territorin e shtetit tjetër kontraktues, e bëjnë pagesën në monedhën e shtetit të parë kontraktues.

2. Me kërkesë të përfituesit, institucioni kompetent për dhënien e përfitimeve sigurohet që këto përfitime të depozitohen në një llogari bankare të hapur nga përfituesi në territorin e shtetit kontraktues ku ky institucion ka qendrën.

Neni 24

Apelimi kundër palës së tretë përgjegjëse

Nëse një person merr përfitime sipas legjislacionit të një shteti kontraktues për një dëm të ndodhur në territorin e shtetit tjetër kontraktues, ka të drejtë në territorin e këtij shteti të dytë t'i kërkojë shkaktarit të dëmit riparimin e këtij dëmi. Të drejtat e institucionit debitor ndaj shkaktarit të dëmit do të zbatohen si më poshtë:

a) Nëse institucioni debitor zëvendësohet sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat që përfituesi ka

ndaj palës së tretë, çdo shtet kontraktues e njëj këtë zëvendësim.

b) Nëse institucioni debitor ka një të drejtë të drejtpërdrejtë ndaj palës së tretë, çdo shtet kontraktues e njëj këtë të drejtë.

Neni 25

Rregullimi i pagesave të tepërta

Nëse institucioni kompetent i një shteti kontraktues ka paguar një përfitim të padrejtë, ai mund t'i kërkojë institucionit kompetent të shtetit tjetër kontraktues që sipas legjislacionit të këtij të fundit, të mbajë nga shumat e prapambetura të përfitimit që ai duhet të paguajë për të njëjtën periudhë, shumën e paguar padrejtësisht, sipas ligjeve të atij shteti kontraktues dhe t'ia paguajë atë atij direkt.

Neni 26

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind mes institucioneve kompetente të shteteve kontraktuese, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje është subjekt i negociatave të drejtpërdrejta midis autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

PJESA V

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 27

Periudhat e sigurimit dhe ngjarjet e mëparshme

1. Kjo Marrëveshje nuk jep asnjë të drejtë për pagesa përfitimesh për një periudhë para datës së hyrjes së saj në fuqi.

2. Çdo periudhë sigurimi e kryer sipas legjislacionit të një shteti kontraktues, para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, është marrë parasysh në përcaktimin e së drejtës për përfitim, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

3. Në bazë të dispozitave të paragrafit 1, një e drejtë fitohet sipas kësaj Marrëveshjeje edhe nëse kjo lidhet me një rast të ndodhur para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 28

Rishikimi i së drejtës

1. Përfitimet e papaguara ose të pezulluara për shkak të shtetësisë së të interesuarit ose për shkak



të vendbanimit të tij në territorin e shtetit tjetër kontraktues nga ai i institucionit që ka detyrimin për të kryer pagesën ose për çdo pengesë tjetër që ka dalë para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, paguhen ose rivendoset e drejta, me kërkesën e të interesuarit, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, përveç se në rastin kur përfitimet e paguara më parë janë bërë me një pagesë të menjëhershme ose rimbursimi i kontributeve ka çuar në humbjen e të drejtës për përfitim.

2. Të drejtat e personave të interesuar, të cilët para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kanë marrë pagesën e një pensioni, mund të rishikohen me kërkesën e tyre, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Këto të drejta, gjithashtu, mund të rishikohen pa kërkesë nga institucioni zbatues kur konstatohen gjatë veprimtarisë së tyre. Në çdo rast, një rishikim i tillë nuk duhet të ketë reduktimin e të drejtave që kishte më parë i interesuari.

Neni 29

Afatet e dorëzimit të kërkesave

1. Nëse kërkesa e përmendur në nenin 28, dorëzohet brenda dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të drejtat në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të fitohen nga data e hyrjes në fuqi e Marrëveshjes.

2. Nëse kërkesa e paraqitur në nenin 28, është paraqitur pas dy vjetësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të drejtat që nuk janë dhënë kanë efekt nga data e kërkesës, në rastin se nuk do të ketë dispozita më të favorshme të legjislacionit kombëtar.

Neni 30

Garantimi i të drejtave të fituara ose që janë duke u përfituar

1. Në rast të ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të drejtat e fituara në bazë të dispozitave të saj do të ruhen.

2. Të drejtat që lindin nga periudhat e sigurimit të plotësuar para datës në të cilën ndodh efektivisht zgjidhja e Marrëveshjes nuk shuhet nga kjo zgjidhje, vazhdimësia e tyre përcaktohet me një marrëveshje të përbashkët, për periudhën në vijim dhe në mungesë të saj, nga legjislacioni që zbatohet në institucionin në fjalë.

Neni 31

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore. Ajo mund të ndërpritet me kërkesën e secilit shtet kontraktues nëpërmjet rrugëve diplomatike, të paktën gjashtë muaj para mbarimit të vitit kalendarik në vazhdim. Në këtë rast ajo do të humbë vlefshmërinë e saj në ditën e fundit të këtij viti kalendarik.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit të tretë nga data e marrjes së njoftimit, nëpërmjet të cilit shteti i fundit kontraktues i komunikon shtetit tjetër kontraktues që të gjitha detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni vendas janë përmbushur.

Bërë në....., në datën ... në dy kopje, në gjuhën shqipe, frënge dhe ku secili tekst është autentik.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë